



UBT STATS

Ndërlidhja në mes të NACE Rev. 1 dhe NACE Rev. 2

Klasifikimi NACE është një klasifikim ndërkombëtar statistikor sipas aktiviteteve ekonomike. Në funksion të prezantimit më të drejtë të aktiviteteve ekonomike, aktivitetet janë ndarë në disa kategori duke filluar nga bujqësia e deri tek ato më specifike. Klasifikimi, respektivisht nomenklatura NACE është kodifikim shumë i detajuar që ndihmon kategorizimin e saktë të aktiviteteve ekonomike. Kjo nomenklaturë ka aplikim shumë të madh sidomos tek statistikat e prodhimit të brendshëm bruto, statistikat e klasifikimit të aktiviteteve të ndërmarrjeve, etj.

Me qëllim të konvergencës me sfidat e klasifikimit adekuat bashkëkohor, nomenklatura NACE ka kaluar nëpër disa përditësime, ku versioni i fundit është ai NAVE Rev. 2. UBT STATS ka paraqitur në vazhdim krahasimin dhe korrelacionin e dy versioneve, NACE Rev.1 dhe NACE Rev.2

NACE Rev. 2		NACE Rev. 1	
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria
		B	Peshkimi
B	Xehetari dhe gurëthyes	C	Industria e minierave dhe ekstraktuese
C	Prodhim	D	Industria përpunuese (prodhimi)
D	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	E	Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë
E	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës		
F	Ndërtimtari	F	Ndërtimtaria
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve motorike, motoçikletave, mallrat personale dhe të amvisërisë
i	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	H	Hotelet dhe restorantet

H	Transport dhe ruajtje	i	Transporti, depot dhe telekomunikacioni
J	Informacion dhe komunikim		
K	Aktivitete financiare dhe sigurimi	J	Aktivitetet financiare
L	Aktivitete të patundshmërisë	K	Pasuritë e patundshme, dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike		
N	Aktivitete administrative dhe mbështetëse		
O	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	L	Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale
P	Arsim	M	Arsimi
Q	Shëndetësi (anglisht: <i>human health</i>) dhe aktivitete të punës sociale	N	Shëndetësia
R	Art, zbavitje dhe rekreacion		
S	Aktivitete të shërbimeve tjera	O	Aktivitetet tjera sociale dhe personale
T	Aktivitete të ekonomive familjare si punëdhënës	P	Ekonomitë shtëpiake private me persona të punësuar
U	Aktivitete të organizatave dhe organeve jashtë-territoriale		